



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.157 dt.29.09.1997

**MBI**

**DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN GUSHT 1997.**

Në bazë të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore” ndryshimeve të tij si dhe vendimeve dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi relacionin dhe projekt vendimin e Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **11.671 familje** me një fond prej **33.032.356 lekë**. Për çdo Njësi Administrative sipas relacionit.
2. Të miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje sipas relacionit.
3. Të trajtohen në mënyrë të diferencuar **2 familje** : Zija Stoja 7 p, Nj.A.3, Meta Sefaj, 5 p, Nj.A.4.
4. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin gusht **128 familje** sipas pasqyrës përkatëse.
5. Të dalin nga skema e ndihmës ekonomike **183 familje** sipas pasqyrës përkatëse.
6. Të rifitojë në skemën e ndihmës ekonomike **33 familje** sipas relacionit.
7. Të miratohet kërkesa e Fredi Shekollarit për rihyrjen në skemën e ndihmës ekonomike, Nj.A.8.
8. Të miratohen si raste të veçanta të trajtimit me ndihmë ekonomike : Altin Beshinaj si familje me 4 antarë, Nj.A.6, Besjana Sylkeshi si familje me 2 antarë, Nj.A.4, Redona Dudushi, Nj.A.4, me ndihmë të pjesshme, Aishe Kurti, familje me 1 anëtar, Nj.A.4, Nazmie Rushiti, familje me 1 anëtar, Nj.A.7.
9. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1506 persona** me aftësi të kufizuar dhe **62 persona** për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar me një fond gjithsejt prej **5.152.616 lekë**.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**

